

BASHKIA TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT

1. **Drejtuar:** Operatori Ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k
2. **Adresa:** Tiranë, Bulevadi Zhan D’ark, Nd. 32, Hyrja 16, Kati 2, Ap. 1.
3. **OE/BOE me nënkontraktor**
PO ☐ JO ☒
4. **OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**
PO ☐ JO ☒
5. **Tipi i Kontratës:** Shërbime
6. **Lloji i Procedurës së prokurimit:** Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar - Shërbim
7. **Numri i Procedurës / referenca e Lotit:** REF- 87918-05-28-2026
8. **Përshkrimi i shkurtër i kontratës:** “Abonime të reja software dhe mirëmbajtje software të licensuar në përdorim”.
9. **Fondi limit:** 72,716,160 (shtatëdhjetë e dy milion e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh.
Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 761,824.62 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzet e katër pikë gjashtëdhjetë e dy) euro pa tvsh.
10. **Burimi i financimit:** të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2026, miratuar me VKB Nr.100, datë 18.12.2025, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026-2028 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026” (i ndryshuar).
11. **Kohëzgjatja e kontratës:** 24 (njëzet e katër) muaj kalendarik.
12. **Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE:** 29.05.2026.
13. **Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike:** Nr.35, datë 01.06.2026.
14. **KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “ICOM” sh.p.k

NUIS L12402023H

Vlera: 0 (zero) lekë pa TVSH.

2. Operatori Ekonomik “INSTANT.AL” sh.p.k

NUIS L81506043D

Vlera: 42,000,000 (dyzetë e dy milion) lekë pa TVSH.

3. Operatori Ekonomik “PC STORE” sh.p.k

NUIS L01606034A

Vlera: 41,720,000 (dyzetë e një milion e shtatëqind e njëzetë) lekë pa TVSH.

4. Operatori Ekonomik “Communication Progress” sh.p.k

Vlera: **34,999,920** (tridhjetë e katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa TVSH.

5. Operatori Ekonomik “Advanced Business Solutions- ABS” sh.p.k

NUIS K21710002J

Vlera: **48,750,000** (dyzetë e tetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

6. Operatori Ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k

NUIS J61817047D

Vlera: **48,604,350** (dyzetë e tetë milion e gjashtëqind e katër mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

7. Operatori Ekonomik “C.C.S” sh.p.k

NUIS J61901033C

Vlera: **68,352,600** (gjashtëdhjetë e tetë milion e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.

8. Operatori Ekonomik “Infosoft Systems” sh.p.k

NUIS J61820021C

Vlera: **54,537,140** (pesëdhjetë e katër milion e pesëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëqind e dyzetë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “ICOM” sh.p.k

Operatori Ekonomik “ICOM” sh.p.k nuk përmbush kërkesat për kualifikim të përcaktuara ne DST, pasi nga verifikimi rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument për përmbushjen e kritereve teknike, ekonomike dhe ligjore në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

2. Operatori ekonomik “INSTANT.AL” sh.p.k

Operatori Ekonomik “INSTANT.AL” sh.p.k nuk përmbush kërkesat për kualifikim të përcaktuara në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik pjesë e Kritereve të vecanta të kualifikimit:

... “2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

- b) *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara...*

Në rastin konkret, nga verifikimi i faturave tatimore të paraqitura, rezulton se vlera e realizuar dhe e provuar mbetet nën pragun minimal prej 40% të fondit limit, duke mos përmbushur kërkesën e përcaktuar në dokumentet e procedurës.

3. Operatori ekonomik “PC Store” sh.p.k

Operatori Ekonomik “PC Store” sh.p.k nuk përmbush kërkesat për kualifikim të përcaktuara në pikën 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar pjesë e Kriterëve të vecanta të kualifikimit:

“2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: “c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël” ... ”

Në pikën 2.3.2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar pjesë e Kriterëve të vecanta të kualifikimit Autoriteti Kontraktor kërkon:

“2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit ose autorizim distributori të autorizuar për zërat:

- *Rinovimi i licensës së “Veeam backup & replication enterprise versioni 12”*
- *Abonim për software për krijim/dizenjim objektsh 2D, 3D;*
- *Rinovim i licensës “Fortimail”;*
- *Abonim i platformës së monitorimit*

(Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/email/website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se operatori ekonomik ka dorëzuar autorizim prodhuesi/distributori të autorizuar vetëm për zërin ‘Abonim për software për krijim/dizenjim objektsh 2D, 3D’. Për zërat e tjerë të kërkuar shprehimisht në pikën 2.3.2, përkatësisht:

- *Rinovimi i licensës ‘Veeam Backup & Replication Enterprise, versioni 12’;*
- *Rinovimi i licensës ‘FortiMail’;*

- Abonimi i platformës së monitorimit,

operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion provues.

Për rrjedhojë, dokumentacioni i paraqitur provon përmbushjen e kriterit vetëm për njërin prej katër zërave të kërkuar dhe nuk provon përmbushjen e plotë të pikës 2.3.2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar pjesë e Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit.

4. Operatori ekonomik “Communication Progress” sh.p.k.

Ngaverifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik “PC Store” sh.p.k, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenit 82 pika 4 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, ku rezultoi se oferta përmbush të gjitha kriteret për kualifikim të përcaktuara në dokumentet standard të tenderit.

Në vijim të vlerësimit, KVO verifikoi nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit dhe në përcaktimin e nenit 82, pika 4 e VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar), nga ku konstatoi se oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Communication Progress” sh.p.k **është ofertë anomalisht e ulët.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE “BNT Electronics” sh.p.k. me adresë: *Tiranë, Bulevadi Zhan D’ark, Nd. 32, Hyrja 16, Kati 2, Ap. 1.*, me vlerë totale prej: **48,604,350** (dyzetë e tetë milion e gjashtëqind e katër mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.